



Si konkluzion, Gjykata e Apelit Vlore, çmon se Apeli i paraqitur prej pales se paditur eshte i bazuar pjeserisht ne ligj e ne keto kushte, ka vend per ndryshimin pjeserisht te vendimit te Shkalles se Pare.

**PËR KËTO ARSYE**

Gjykata e Apelit Vlorë, bazuar në nenin 466, germa "b" të K.Pr.Civile

**V E N D O S I**

Ndryshimin e vendimit gjyqësor civil Nr.433 (1022), datë 31.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, si më poshtë:

Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Lluga" sh.p.k të likujdojë kuotën e ortakut Asim Lluga në masën 25% të kapitalit të Shoqërisë, në shumën 31.454.318 ( tridhjetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë, si dhe interesat bankare mbi këtë shumë, nga data e ngritjes së padisë datë 16.07.2015, deri ditën e ekzekutimit të vendimit, llogaritur këto interesa sipas bonove të thesarit në kohën respektive.

Shpenzimet gjyqësore, në proporcion me pjesën e pranuar dhe të rrëzuar të padisë.

**U shpall në Vlorë, më datë 29.05.2019**

**ANËTAR**  
**Hysen SALIKO**

**ANËTAR**  
**Sokol NGRESI**

**KRYESUES**  
**Skënder DAMINI**



pra, vleres shtese te aktiveve qe vjen nga rivleresimi do te zbritel 15% e vleres se saj, Vlera totale per tu shperndare, nisur nga treguesit financiar te shoqerise si dhe nga vleresimi i aktiveve eshte ne vleren 162.779.833 leke, vlere e cila do te shperndahet ne raport me numrin e aksioneve qe zoterojne aksionaret ne shoqeri.

Gjate gjykimit ne Shkalle te Pare, e pikerisht ne séancen gjyqesore date 16.03.2016, i padituri Hajro Lluga, lidhur me pyetjen e gjykates, eshte pergjigjur se ata i kane propozuar paditesit te merrte shumen 320.000 euro, por ai nuk ka pranuar (faqe 20 e procesverbalit gjyqesor).

Siç u shprehem edhe me lart, nga akti i ekspertimit, rezulton se pjesa takuese e paditesit Asim Lluga, i cili eshte aksioner ne shoqeri dhe zoteron 25 aksione, ose 25 % te kapitalit, eshte e barabarte me vleren 40694958 leke ( $1627798330 * 25 \%$ ), sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2016 dhe vleres shtese te asetave qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme. Brenda kesaj shume, perfshihen edhe aksionet e paditesit, lidhur me pasurite e paluajtshme te parregjistruara.

Ne akt ekspertimi shtese, e pikerisht ne faqen 6 te tij (faqe 418 e dosjes gjyqesore), jane te percaktuara hollesisht edhe pasurite e paluajtshme te parregjistruara, ne bashkepronesi te paleve, pra pasuri te shoqerise "Lluga" sh.p.k. per te cilat paditesi kerkon qe edhe nga ato, te merret pjesa e tij e kuotes. Keto pasuri jane ne proces legalizimi. Vlera totale e tregut te lire, e pasurive te parregjistruara, eshte 12.492.360 leke.

Gjykata e Apelit Vlore, konkludon se lidhur me pasurite e mesiperme, pas legalizimit dhe rregjistrimit te tyre, paditesi Asim Lluga, legjitimohet te ngreje padine ne gjykate, me te njejtin objekt qe ka ngritur ne kete padi dhe me te njejtin te paditur. Pra, si konkluzion, Gjykata e Apelit Vlore, shprehet se keto pasuri nuk mund ti nenshtrohen shqyrtimit gjyqesor.

Perfundimisht, si konkluzion, Gjykata e Apelit Vlore, çmon se kuota e ortakut Asim Lluga në masën 25% të kapitalit të Shoqërisë, është në shumën 31.454.318 ( tridhjetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Lidhur me interesat, per shumen e mesiperme, Gjykata e Apelit Vlore, konkludon se interesat bankare mbi këtë shumë, duhet të llogariten nga data e ngritjes së padisë datë 16.07.2015, deri ditën e ekzekutimit të vendimit, llogaritur këto interesa sipas bonove të thesarit në kohën respektive.

Lidhur me shpenzimet gjyqesore, konform nenit 106 te K.Pr.Civile, ato duhet te paguhen ne proporcion me pjesen e pranuar e te rrezuar te padise, pra per pjesen e pranuar, i ngarkohen pales se paditur e per pjesen e rrezuar pales paditese.

vleres se tregut te zerave te mesiperm, jane marre ne konsiderate amortizimi vjetor, dokumentacioni i regjistrimit te pasurive dhe si konkluzion vlerat aktuale te tregut te lire per pasurite e paluajtshme te permbledhura te regjistruara dhe parregjistruara (makineri dhe pajisje): -Trualli me vlere aktuale te tregut = 29.543.800 leke; Ndertestat (me leje dhe pa leje)= 65.160.560 leke; Makineri e pajisje (te deklaruar ose jo) =42.965.000 leke, ne Total vlere e tregut= 137.669.360 leke. Ne total, vlere shtese e aktiveve qe vjen nga vleresimi i aktiveve afatgjata materiale eshte ne shumen 74041217 leke (vlere sipas vleresimit te ekspertit =137669360 leke - vlere neto kontabile date 31.12.2016 =63628143 leke)....Si rezultat i analizes financiare te treguesve te pasqyruar ne tabelen e mesiperme, shohim qe ne vitin 2012 shoqeria ka qene me humbje ne rezultatin financiar me nje vlere te larte ne shumen 31597801 leke. Kjo humbje eshte mbartur ne vitet pasardhese dhe eshte rikuperuar plotesisht ne vitin 2015. Te ardhurat e shoqerise jane rritur dhe konkretisht ne vitin 2016 kane qene 108851453 leke ose ne krahasim me vitin 2015 jane rritur 19% (108851453leke/97703128 leke\* 100).

Shoqeria ka rritur rezultatin financiar ne vitin 2014 me norme fitimit bruto 14.4%, ne vitin 2015 ka qene me norme 25.1 % dhe ne vitin 2016 me norme fitimi bruto 16.56%, krahasimi i fitimit bruto te vitit 2015 me fitimin bruto te vitit 2014 kemi nje rritje ne masen 323 % ose ne vleren absolute 16.907.238 leke (24.486.819 leke viti 2015 - 7.579.581 leke viti 2014), ndersa fitimi bruto per vitin 2016, ne vlere absolute, eshte 18.025.476 leke.

Me fitimin e realizuar ne vitin 2015, jane perballuar humbjet e mbartura nga viti 2012, te cilat jane ne shumen -17.882.403 leke, paguar tatim fitimi ne shumen 1.508.296 leke, si dhe mbetja ne shumen 5.096.120 leke ka ndikuar ne rritjen e kapitalit te shoqerise, gjilhashtu gjate vitit 2016 ka ndikim ne rritjen e kapitalit dhe fitimi neto i realizuar gjate ketij viti ne vleren 15.321.654 leke. Nisur nga informacioni i marre nga pasqyrat financiare te vitit ushtrimor 2016, te cilat pasqyrojne situaten financiare ne daten 31.12.2016, rezulton se aktivet afatgjata jane ne vleren 63.628.143 leke, aktivet afatshkurtra jane ne vleren 80.338.844 leke, detyrimet jane ne vleren 4.412.189 leke. Vlere totale per tu shperndare, nisur nga treguesit financiar te shoqerise jane ne vleren 99.844.798 leke, vlere, e cila do te shperndahet ne raporl me numrin e aksioneve qe zoterojne aksionaret ne shoqeri. Pjesa takuese e paditesit Asim Lluga, i cili eshte aksionar ne shoqeri dhe zoteron 25 aksione ose 25% te kapitalit eshte e barabarte me vleren 24.961.200 leke (99844798 leke \* 25%), sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2016 (ne te cilen nuk jane llogaritur vlere shtese e aktiveve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme). Nisur nga vleresimi i aktiveve afatgjata materiale (AAM) te kryera nga eksperti vleresues, vlerat e te cilave jane pasqyruara ne Tabelen 8 si dhe bazuar informacionin financiar te dhene ne pasqyrat financiare te vitit ushtrimor 2016, rezulton se: vlere neto te aktiveve do ti shtohet diferenca qe vijne nga vleresimi i aktiveve te kryera nga eksperti vleresues. Per te percaktuar vleren e aksionit duke perfshire dhe vleren shtese qe vjen nga vleresimi i aktiveve, do te merret ne konsiderate dhe tatimet qe aplikohen per zmadhimin e kapitalit nepermjet procesit te rivleresimit te aktiveve, ne rastin konkret eshte ne masen 15%,

Ekspertet, ne séance gjyqesore, ne te dyja Shkallet e gjykimit, dolen ne konkluzionin se pjesa takuese e paditesit Asim Lluga, i cili eshte aksioner ne shoqeri dhe zoteron 25 aksione, ose 25 % te kapitalit, eshte e barabarte me vleren 40694958 leke ( $1627798330 * 25 \%$ ), sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2016 dhe vleres shtese te asetave qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme.

***Konkluzioni i arritur nga grupi i eksperteve, çmohet pjeserisht i gabuar prej Gjykates se Apelit Vlore, me arsyetimin e meposhtem:***

Struktura e aktiveve te shoqerise ne date 31.12.2016, paraqiten me vleren e mbetur. Ne total vlera fillestare e aktiveve te shoqerise, eshte ne shumen 113.017.181 leke (duke perfshire shtesat gjale vitit 2016), amortizimi progresiv eshte ne vleren 49389038 leke dhe vlera e mbetur e aktiveve ne date 31.12.2016 eshte ne shumen 63.628.143 leke. Gjykata e Shkalles se Pare, ka caktuar ekspertin vleresues pasurish lnxh.Kalo Xhuvani per te bere vleresimin me vleren e tregut te ketyre aktiveve afatgjata materiale, vleren e te cilave po e rehatojme si vijon:

Nga inspektimi dhe matjet faktike te bera ne vend te te gjithë objekteve qe ndodhen brenda territorit te regjistruar prej 13.424 m<sup>2</sup> te kesaj firme, rezulton se gjendja aktuale e ndertesave dhe punimeve te brendshme eshte:

Gjithe siperfaqja eshte e rrethuar me avlli dhe me porta hyrese-dalese dhe me infrastrukture te brendshme te sistemuar me sheshe dhe rruge te brendshme e te shtruara me asphalt, te cilat lidhin te gjithë repartet e kesaj firme, avlli me mur rrethues ne perimetrin e jashtem te pronesise, ndertesa nje kateshe ne funksion te repartit te punes qe nuk perfshihen brenda lejes dhe objekteve te regjistruara, pjese reparti midis dy reparteve ekzistues duke perdorur kolonat mbeshtetese ekzistuese depozite uji te betonuar, instalime tubacione dhe qender gazi, vendroje. Nisur nga te dhenat e tregut te lire, duke perdorur metoden e krahasimit te drejtperdrejte nderthurur me metoden e kosos vleresoj se vlera aktuale e pasurise se paluajtshme ndertesave dhe tokes perfshi amortizimin vjetor per ndertesat 0.98% ndersa per token 0%, si dhe duke perfshire vlerat e ndertesave pa leje perllogariten keto vlera per pasurite e paluajtshme:

Per ndertimet me leje te regjistruara: Siperfaqe Ndertimore prej 4310 m<sup>2</sup> x 15000 x 0.94% = 52.668.200 leke;

Toka me Siperfaqe 13.429 leke x 2.200 leke - 29.543.800 leke

Makineri e pajisje te deklaruar ne bilanc = 29.863.547 leke;

Vlera totale e tregut te lire e pasurive te regjistruara eshte 112.075.547 leke;

Siperfaqe ndertimore pa leje (te paregjistruara); Ndertese 1 kt me Siperfaqe 100 m<sup>2</sup> zyra, magazine - 1.100.000 leke Ndertese 1 kt me Siperfaqe 140 m<sup>2</sup> zyra , magazine = 2.520.000 leke; Ndertese 1 kt vendroje me Siperfaqe 9 m<sup>2</sup> =135.000 leke Magazine (ndermjet dy reparteve) Siperfaqe 574 m<sup>2</sup> = 3.237.360 leke. Ndertim infrastrukture, rruge, sheshe, shtrime, avlli, vendroje etj me nje vlere prej 5.500.000 leke. Vlera totale e tregut te lire e pasurive te parregjistruara eshte 12.492.360 leke. Neper llogaritjen dhe percaktimin e

1KT 540 m<sup>2</sup>), e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.2087 Vol.20 faqe 33 ne fshatin Karbunare e Poshtme Lushnje;

-Pasuria Nr. 101/50 are + truall me siperfaqe 3811 m<sup>2</sup> (nga kjo: truall = ndertese 920 m<sup>2</sup>), e ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr.2087, Vol.21, faqe 145, ne fshatin Karbunare e Poshtme Lushnje.

Ne total te regjistruar ne hipoteke ne emer te shoqerise "LLUGA " shpk kemi Are + Truall + Ndertese = 13429 m<sup>2</sup> (nga e cila: toke Are = 5052 m<sup>2</sup>; Truall = 4067 m<sup>2</sup> dhe Ndertesa = 4310 m<sup>2</sup>). Nga Gjykata eshte caktuar ekspert vleresues pasurish per te here vleresimin me vleren e tregut te ketyre aktiveve afatgjata materiale. Si rezultat i analizes financiare te treguesve te pasqyruar ne tabelen e mesiperme, shohim qe ne vitin 2012 shoqeria ka qene me humbje ne rezultatin financiar me nje vlere te larte ne shumen 31597801 leke. Kjo humbje eshte mbartur ne vitet pasardhese dhe eshte rikuperuar plotesisht ne vitin 2015. Te ardhurat e shoqerise jane rritur dhe konkretisht ne vitin 2015 kane qene 97703128 leke ose ne krahasim me vitin 2014 jane rritur 85.66% (97703128 leke/52624765 leke). Shoqeria ka rritur rezultatin financiar ne vitin 2014 me norme fitimi bruto 14.4% dhe ne vitin 2015 ka qene me norme 25.1 %, krahasimi i fitimit bruto te vitit 2015 me fitimin bruto te vitit 2014, kemi nje rritje ne masen 323% ose ne vleren absolute 16907238 leke (24486819 leke viti 2015 - 7579581 leke viti 2014). Me fitimin e realizuar ne vitin 2015 jane perballuar humbjet e mbartura nga viti 2012 te cilat jane ne shumen -17882403 leke, paguar tatim fitimi ne shumen 1508296 leke, si dhe mbetja ne shumen 5096120 leke ka ndikuar ne rritjen e kapitalit te shoqerise. Ne lidhje me detyrimet qe behen te kerkueshme brenda vitit ne vazhdim (brenda per iudhes 12-mujore te ardhshme), shoqeria ka aftesi per te mbuluar detyrimet per faktin se aftesia likuide e saj ne aktiv te bilancit jane te tilla dhe kane diference te konsiderueshme. Nisur nga informacioni i marre nga pasqyrat financiare te vitit ushtrimor 2015 ti cilat pasqyrojne situaten financiare ne daten 31.12.2015, rezulton se aktivet afatgjata jane ne vleren 71719142 leke, aktivet afatshkurtra jane ne vleren 6.3953.270 leke, detyrimet afatgjata jane ne vleren 12.707.139 leke, si dhe detyrimet afatshkurtra jane ne vleren 38.442.129 leke (detyrime te kerkueshme per 12 muaj) Vlera totale per tu shperndare nisur nga ireguesil financiar te shoqerise jane ne vleren 84.523.144 leke, vlere, e cila do te shperndahet ne raport me numrin e aksioneve qe zoterojne aksionare ne shoqeri. Pjesa takuese e paditesit Asim Lluga, i cili eshte aksione ne shoqeri dhe zoteron 25 aksione ose 25% te kapitalit eshte e barabarte me vleren 21130786 leke (84523144 leke, 25%), sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2015 (ne te cilen nuk jane llogaritur vlera shtese e aktiveve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme)..”

Ne gjykimin e kesaj ceshtjeje ne Shkalle te Dyte, Gjykata e Apelit Vlore, pasi studioi dosjen gjyqesore, konform nenit 465 te K.Pr.Civile, kryesisht vendosi te perserise pjeserisht hetimin gjyqesor te ceshtjes, duke thirrur ekspertet Barjam Callmori e Kalo Xhuvani, per te dhene spjegime rreth aktit te ekspertimit, te relatuar prej tyre gjate gjykimit ne Shkalle te Pare.

**Lidhur me sa me sipër, Gjykata e Apelit Vlorë, konkludon sa me poshtë:**

***Lidhur me vlerën e kuotes se ortakut Asim Lluga, Gjykata e Shkallës së Pare Lushnjë, në pjesën arsyetuese, shprehet si me poshtë:***

“...Në lidhje me shumën konkrete për likuidimin e kuotes gjykata i referohet aktit të ekspertimit të administruar në gjykim: "Bazuar në dokumentacionin e ndodhur në dosjen gjyqësore, rezultoi se: Shoqëria tregtare "LLUGA" sh.p.k me NIPT: J94808406B me sell në Lushnjë, me administrator Hajro Lluga është krijuar me Vendim të Gjykatës Nr.12439, datë 13.10.1995, me ortak të vetëm Hajro Lluga, i cili zotëronte 100% të kapitalit themeltar në vlerën 100.000 leke.

Në datë 18.07.2007, me vendim të ortakut të vetëm të kësaj shoqërie Hajro Lluga është here zmadhimi i kapitalit të shoqërisë nga 100000 leke në 660000 leke, numri i aksioneve mbetet 100, ndërsa vlera për aksion nga 1000 leke bëhet 660000 leke, numri i ortakëve mbetet një.

Në vitin 2008 shoqëria tregtare "LLUGA" shpk ka pësuar ndryshime në numrin e aksionarëve si vijon:

Në datë 13.01.2008, me vendim të ortakut të vetëm të kësaj shoqërie Hajro Lluga, aksionaret e kësaj shoqërie bëhen 3 (tre), numri i aksioneve mbetet 100, ndërsa pjesëmarrja e aksionarëve është: Hajro Lluga me 50 aksione ose 50% e kapitalit, kontributi në para 33000000 leke; Pellumb LLuga me 25 aksione ose 25% e kapitalit, kontributi në para 16500000 leke; Asim LLuga me 25 aksione ose 25% e kapitalit, kontributi në para 16500000 leke.

Në analizën e treguesve financiarë dhe strukturës së asetëve do të bazohemi në pasqyrat financiarë të depozituara në Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier nga subjekti "LLUGA" shpk për vitet ushtrimore 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Në këto pasqyra financiarë rezultoi se është pasqyruar kërkesa e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit për pasqyrimin me vlerën nëlo të aktiveve afatgjata materiale. Gjithashtu, ka gjetur pasqyrim dhe zbatim aplikimi normës së amortizimit për aktivet afatgjata materiale, sipas kërkesave të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Aktivet dhe Pasivët e pasqyrave financiarë janë të rakorduara, detyrimet e shoqërisë janë të mbuluara plotësisht nga aktivet e saj. Fitimet e shoqërisë nga njëri vit në tjetrin janë në rritje, shoqëria ka bërë progres për rritjen e performancës së saj, pas vitit 2013 detyrimet e shoqërisë vijne duke u zvogeluar (pakesuatj). Në total vlera fillestore e aktiveve të shoqërisë është në shumën 112910514 leke, amortizimi progresiv është në vlerën 41191372 leke dhe vlera e mbetur e aktiveve në datë 31.12.2015, është në shumën 71719142 leke. Aktivet afatgjata materiale që janë të regjistruar në pasqyrat financiarë dhe të regjistruar në hipoteke për llogari të shoqërisë "LLUGA" shpk janë si më poshtë:

-Pasuria Nr. 101/47 tokë are me sipërfaqe 2161 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr.2087 Vol.20 faqe 31 në fshatin Karbunare e Poshtme Lushnjë;

-Pasuria Nr. 101/48 truall + ndertese me sipërfaqe 4950 m<sup>2</sup> (nga kjo: ndertese 1KT 2850 m<sup>2</sup>), e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr.2087, Vol.20, faqe 32, në fshatin Karbunare e Poshtme Lushnjë;

-Pasuria Nr.101/49 truall + ndertese me sipërfaqe 2507 m<sup>2</sup> (nga kjo: ndertese

Ne rastin e perjashtimit te nje ortakut nga shoqeria, iniciativa duhet te merret nga ortaketi e tjere ose nga administratoret e shoqerise. Si nje hap i pare formal, duhet te thirret asambleja e pergjithshme, e cila ka te perfshire ne rendin e dites kerkesen per perjashtimin e ortakut. Vendimi per perjashtimin e nje ortakut kerkon nje shumice te thjeshte votash te ortakeve pjesemarres. Vendimi i asamblese se pergjithshme eshte vetem nje hap drejt perjashtimit, pasi procedura per perjashtimin gjithmone kerkon ne vendim gjyqesor, sikurse rezulton nga interpretimi sistematik i Nenit 102 (1) i LSHT-se qe shprehimisht parashikon se "*asambleja e pergjithshme mund (ka te drejte) t'i kerkoje gjykates te perjashtoje nje ortak*", dhe nenit 103 (1) i LSHT-se i cili parashikon se: "*te gjitha te drejtat, qe rrjedhin nga cilesia e ortakut ne shoqeri, shuhen*", kur gjykata jep vendim perfundimtar ne lidhje me perjashtimin.

Sipas kuptimit te nenit 101/3 te ligjit, administratori duhet te therrase menjehere mbledhjen e asamblese se ortakeve pra, si rregull, periudha nga momenti i njoftimit te ortakut per largim dhe deri ne momentin e mbledhjes eshte nje afat kohor shume i shkurter, pasi ligji e detyron administratorin te therrase menjehere mbledhjen per te vendosur nese ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.

Kuota e nje ortakut te larguar duhet te likuidohet, pervec rastit kur ka munguar plotesisht kontributi i tij. Gjykata vlereson se e drejta e nje ortakut per t'u larguar nga shoqeria nese ekziston nje shkak i arsyeshem qe e ben te papranueshme vazhdimin e ortakerise, nuk e perjashton te drejten per tu kompensuar per vleren e kuotes te cilen ortakut e dorezon me largimin e tij, ne te kundert e drejta per tu larguar nuk do te kishte asnje dobi dhe interes ekonomik per ortakun. Gjithashtu ekzistenca e shkakut te perjashtimit nuk justifikon ne asnje menyre zhveshjen e ortakut nga e drejta mbi kuoten e tij ne shoqeri pa ndonje kompensim per te, parashikuar ne nenin 102 te LSHT-se, dhe ndersa paragrafi i 4 i po ketij neni, i jep shoqerise nje te drejte per shperblimin e demit te pesuar nga veprimet qe kane sjelle perjashtimin. Paragrafi i 6 i Nenit 102 te LSHT-se, ne pjesen e pare te fjalise, i mohon ortakut te drejten per kompensim per vleren e kuotes se tij, ne rastin e nje perjashtimi te justifikuar, megjithate, dispozita ne vazhdim ne pjesen tjeter te se njejtës fjali, kur parashikon se ortakut ka te drejte te kompensoje çdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfitonte ne cilesine e likuidimit te kuotes, me demin e kerkuar nga shoqeria nese kjo e fundit ngre padi ndaj tij per shperblim demi.

Debitori i likuidimit te kuotes eshte shoqeria dhe jo ortaketi e tjere. Ne ligj nuk flitet se si do kryhet likuidimi i kuotes, procedural dhe afatet e ketij likuidimi.

**Në Apelin e tij në Shkalle te Dyte, paditesi pretendon se Gjykata e Apelit Vlore, duhet të vendosë** vlerësim të pasurisë dhe likuidim të kuotes së Ortakut të minorancës prej 25% të aksioneve-pasurisë të shoqërisë "Lluga" sh.p.k. duke u përlogaritur kjo kuotë, deri ne datën që ky vendim të marrë formë të prerë në shumën totale 49 500 240 (dyzetë e nëntë milion e pesëqind mijë e dyqind e dyzetë) lekë, si dhe interesat bankare mbi këtë shumë, nga ngritja e padise deri ditën e ekzekutimit te vendimit.

Megjithate, Gjykata vlereson se, referuar Ligjit Nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ortaket ne pakice, kane te drejte ti drejtohen gjykates me qellim shqyrtimin e vlefshmerise se vendimeve te asamblese se ortakeve, por edhe refuzimin e mbledhjes se asamblese ne rastet kur kjo mbledhje eshte e detyrueshme. LSHT nuk permбан ndonje dispozite lidhur me pavlefshmerine ose kundershhtimin e nje vendimi te asamblese se ortakeve per shkak se ky vendim ka shkelur ligjin ose statuti. Mungesa e nje dispozite per te kundershhtuar vendimet e paligjshme te shumices pasqyruar ne nje vendim asamble, nuk mund ti mohoje mbrojtjen ortakeve te pakices.

Ne Apelin e tij ne Shkalle te Dyte, pretendim, te cilin e ngriti edhe ne Shkalle te Pare, rezulton se pala paditese Asim Lluga ka parashtruar pretendime ne lidhje me pasqyrat financiare, mirepo me te drejte, Gjykata e Shkalles se Pare, konstaton se nuk u paraqit ne gjykim nese kjo pale i eshte drejtuar gjykates per shqyrtimin e vlefshmerise se mbledhjes apo vendimit te asamblese se ortakeve ne kuader te miratimit te pasqyrave financiare, te cilat prezumohen ne perputhje me ligjin, persa kohe nuk jane kundershhtuar ne formen e kerkuar nga ligji, dhe nje çeshtje e tille nuk mund te hetohet kryesisht nga gjykata, pasi barren e proves e ka paditesi.

Ligji shqiptar per Tregtaret e Shoqerite tregtare, nuk parashikon ndonje afat per te ushtruar te drejten e largimit te ortakut nga shoqeria me pergjegjesi te kufizuar. Ortaku ka te drejte te largohet ne çdo kohe dhe statuti i shoqerise nuk mund te kufizojë kete te drejte te tij. Largimi i ortakut ushtrohet nepermjet deklarimit me shkrim te vullnetit te tij, qe ne thelb eshte nje veprim juridik i njeanshem, me ane te te cilit, ortaku vendos te shuaje te drejta dhe detyrime qe ka marre persiper me ane te marreveshjes se themelimit te shoqerise. Sipas nenit 101/2 te ligjit, ortaku duhet te njoftoje shoqerine me shkrim dhe te parashtroje shkaqet e largimit. Ligji nuk parashikon detaje, nese akti i njoftimit do te jete shkrese e thjeshte, leter rekomande apo akt noterial. Ne keto rrethana shkresa do jete e thjeshte per aq kohe sa ligji nuk parashikon forme te veçante te saj.

Largimi nga shoqeria sjell disa pasoja, sic jane nderprerja e marredhenieve me shoqerine, rimbursimi i kontributit qe ka dhene ortaku qe largohet ne kapitalin e shoqerise, nderprerja e pjesemarrjeve ne mbledhjet e asamblese etj. Ne lidhje me efektet e largimit, megjithese ne ligj nuk parashikohen shprehimisht, ato jane te menjehershme. Ky konkluzion arrihet nga formulimi i nenit 103 i ligjit, i cili trajton pasojat e largimit te ortakut nga shoqeria.

Ne kete dispozite, parashikohet se "te gjitha te drejtat, qe rrjedhin nga cilesia e ortakut ne shoqeri, shuhen ne daten e largimit", qe nenkupton qe largimi sjell pasoja ne ate moment, dhe nga ana tjeter Ligji nuk specifikon ndonje rregull te pergjithshem se kur kompensimi behet i kerkueshem, dhe per kete arsye legjislatori ka rregulluar situaten juridike duke parashikuar dispoziten 101 (4) i LSHT-se i jep mundesi ortakut qe largohet te drejtohet perpara gjykates kompetente duke i kerkuar shoqerise shlyerjen si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme, dhe sipas Nenit 103 (1) te LSHT-se, largimi sjell pasoja kur gjykata merr vendim perfundimtar ne lidhje me largimin.

propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.

Mbledhja e zakonshme e Asamblese se Pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut. Asambleja e pergjithshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim. Asambleja e pergjithshme, thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur Asambleja e Pergjithshme nuk eshte thirrur sipas procedures sa me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut, mund t'i drejtojne administratoreve nje kerkese me shkrim, perfshire posten elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe/ose perfshirjen e ceshtjeve te posaçme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe ceshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim.

Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e rendit te dites, ne perputhje me piken 1 te nenit 83 te Ligjit Nr.9901. Nese, asambleja e pergjithshme nuk thirret, ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, ka te drejte:

- a) te ngreje padi ne gjykate, per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese administratoret nuk permbushin kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve;
- b) t'i kerkoje shoqerise blerjen e kuotave, te zoteruara prej tyre.

Siç ka rezultuar edhe ne Shkalle te Pare, referuar parashikimeve te Ligjit Nr.9901 rezulton se, Asambleja e Pergjithshme nuk eshte mbledhur dhe nuk i eshte komunikuar ndonje nje njoftim me shkrese mbi mbledhjen e asamblese, veprim, i cili perben shkelje te detyrimit te besnikerise, dhe me te drejte ortaku Asim Lluga ka kerkuar blerjen e kuotes se tij.

Ne vijim referuar nenit 90 te Ligjit Nr.9901 "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*", te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal.

Referuar percaktimeve ligjore mbi modalitetet e mbledhjes se asamblese se pergjithshme, Gjykata e Apelit Vlore, ashtu si edhe Shkalla e Pare, vlereson se, nuk rezulton e provuar nese pala e paditur ka zhvilluar ndonje mbledhje, dhe nese ka marre ndonje vendim ne kuader te ketyre mosmarreshjeve.

ligjore, shoqerite tregtare hartojne bilancin dhe raportin per llogarite vjetore dhe i miratojne ato ne APA. Procesi i hartimit behet nga punonjes te shoqerise, ku ben pjese edhe administratori ose eksperte te jashtem te angazhuar nga shoqeria. Hartimi i bilancit dhe i raportit mbi llogarite ka rendesi te madhe pasi rezultatet e tij pasqyrojne te drejtat financiare te aksionareve, fitimet qe ata do te nxjerrin nga shoqeria si dhe gjendjen e financiare te shoqerise ne teresi. Ky proces njihet edhe si procesi i auditimit te pavarur te shoqerise tregtare, proces, i cili realizohet nga ekspertet kontabel qe veprojne ne kuader te Ligjit Nr.10091/2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te audituesit ligjor dhe te kontabilistit te miratuar*". Referuar nenit 57 te Ligjit Nr.9920/2008 "*Per procedurat tatimore*", tatimpaguesi mban kontabilitetin, ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9228, date 29.4.2004 "*Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*" dhe me aktet e nxjerra ne zbatim te tij. Ne kuader te ligjit te sipermendur, pasqyrat financiare paraqesin me vertetesi dhe besueshmeri gjendjen financiare, performancen, ndryshimet ne gjendjen financiare dhe rrjedhjen e parase se njesive ekonomike. Pasqyrat financiare pergatiten dhe paraqiten ne perputhje me standardet kontabel. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nen pergjegjesine dhe sipas procedurave te miratuara nga organi i drejtimit te njesise ekonomike, qe aktivet dhe detyrimet te paraqiten me vertetesi dhe besueshmeri ne pasqyrat financiare vjetore.

Referuar nenit 81, te Ligjit Nr.9901 "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*", Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e adminisiratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "c" te kesaj pike;
- dh) mbikeayrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasayrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasayrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Nderkohe, neni 95, i Ligjit Nr.9901, parashikon se administratoret kane te drejte e detyrohen te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me

- c) perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut; ose  
 ç) me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise.

Ligji parashikon se ortakut ka te drejte te largohet nga shoqeria dhe kuota e tij te likuidohet nese ortakut e tjere ose shoqeria:

- a) kane kryer veprime ne dem te tij;  
 b) nese eshtepenguar te ushtroje te drejtat e tij;  
 c) nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme;  
 d) apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Nje ortak nuk mund te detyrohet te qendroje ne shoqeri ateher kur ai pengohet te ushtroje te drejtat e tij, kur i jane ngarkuar detyrime te paarsyeshme, apo per shkaqe te tjera te arsyeshme. Per sa i perket shkaqeve te tjera te arsyeshme per te cilat lejohet largimi i ortakut, ne ligj nuk gjejmë nje percaktim te detajuar lidhur me ate se çfare do te konsiderohen te tilla, ndaj ne statutin e shoqerise mund te percaktohen shkaqe te tjera, perveç atyre qe parashikon ligji.

Gjithashtu, dhe nga vete ortakut ose asambleja e ortakëve mund te vleresohen shkaqe te tjera si te arsyeshme. E drejta e largimit te ortakut nga shoqeria, eshte pare si nje e drejte, ne veçanti, e ortakut ne pakice per tu mbrojtur nga vendimet e asamblese se ortakëve, me te cilat nuk eshte dakord, ose te cilat ndryshojne ne thelb kontraten/marreveshjen e themelimit te shoqerise.

Për këtë arsye, pala paditëse legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për likuidimin e kuotës së tij në Shoqërinë "Lluga" sh.p.k.

Gjendja financiare e shoqerise nuk mund te konsiderohet si shkak per mos likuidimin e kuotes, pasi edhe nese shoqeria eshte me humbje, mund te filloje procedura e prishjes dhe likuidimit te shoqerise. E drejta e likuidimit te kuotes do te zevendesohet nga e drejta e kuotes se likuidimit dhe ortakut do te marre ate qe mbetet pas likuidimit te kreditorëve te shoqerise, d.m.th. do te ndiqen rregullat e likuidimit.

Gjate gjykimit ne ne te dyja Shkallet, rezulton e provuar se pala paditese Asim Lluga i eshte drejtuar pales se paditur Shoqerise "LLUGA" sh.p.k, mirepo rezulton se, pala e paditur nuk paraqiti ne gjykim shkresa ne lidhje me mbledhjen e asamblese se ortakëve dhe komunikime shkresore ne lidhje me keto mbledhje, per tu diskutuar çeshtjet e parashtruara nga ortakut Asim Lluga, si dhe per tu ushtruar te drejtat e ketij ortakut.

Tregtaret dhe shoqerite tregtare mbajne libra kontabel, hartojne e publikojne te dhenat financiare dhe raportet per gjendjen e ecurise se veprimtarise, perfshire dhe raportet e kontrollit te eksperteve kontabel te autorizuar ne perputhje me ligjin per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, Te pakten nje here ne vit, ose me shpesh, nese parashikohet ne statut ose akte te tjera

Nga interpretimi sistematik i ketyre dispozitave, rezulton se e drejta e ortakeve per tu larguar nga shoqeria, si dhe e drejta e shoqerise per te perjashtuar nje ortak, nuk mund te kufizohen nga statuti (Neni 103 (2) i LSHT-se). Ne thelb te tyre, dispozitat 101 dhe 102 te LSHT-se kane parimin se perfundimi i ortakerise (Neni 103 (1) i LSHT-se) presupozon gjithmone shkaqe te arsyeshme, pasi eshte parashikuar shprehimisht se shkak duhet te jete i tille qe te *"beje te papranueshme vazhdimin e ortakerise per ortakeri"*.

Gjithashtu, pavaresisht se ne nenin 102 te LSHT-se, mungon ideja e shprehur se sjellja e ortakut qe duhet te perjashtohet duhet te jete e tille qe te *"beje te papranueshme vazhdimin e ortakerise"*, per ortaket e tjere dhe per rrjedhoje te justifikojte perjashtimin", Gjykata e Apelit Vlore, ashtu si edhe

Gjykata e Shkalles se Pare Lushnje, thekson se shkaqet per largimin apo perjashtimin te parashikuara ne dispozitat 101 dhe 102 te LSHT-se, duhet te interpretohen se largimi apo perjashtimi, justifikohet vetem ne rast se ekziston nje shkak i arsyeshem per ortakun, i cili deshiron te largohet ose nje shkak i arsyeshem per ortaket e tjere, ne rastin e perjashtimit te nje ortakut.

Sipas Nenit 102 (2) (b) te LSHT-se, nje ortak mund te perjashtohet, veçanerisht, nese ai me dashje apo me pakujdesi te rende, shkel statutin apo detyrime te parashikuara nga ligji, dhe nga permbajtja e neneve rezulton se jo çdo shkelje me dashje e statutit apo ligjit, justifikon perjashtimin. Nese dispozita e shkelur e statutit, eshte shume e parendesishme/ose askush nuk ka pesuar ndonje dem si pasoje e kesaj shkelje, kurrsesi nuk mund te justifikojte nje mase kaq ekstreme siç eshte perjashtimi i ortakut.

Per sa me siper, Gjykata e Apelit Vlore, vlereson te theksoje se nje ortak mund te largohet nga shoqeria, nese ekziston nje shkak i arsyeshem, i cili e ben te papranueshme vazhdimin e ortakerise per vete ate, veçanerisht:

- a) nese ortaket e tjere te shoqerise i kane shkaktuar atij dem me veprimet e tyre;
- b) nese ortakut eshte parandaluar nga ushtrimi i te drejtave te tij ne shoqeri;
- c) nese shoqeria i ka ngarkuar atij detyrime te paarsyeshme",

dhe nga ana tjeter *"Asambleja e pergjithshme mund te marre nje vendim te zakonshem duke i t'i kerkuar gjykates kompetente te perjashtojte nje ortak nese ky i fundit nuk arrin te realizoje nje kontribut siç kerkohet nga statuti ose nese ekziston nje shkak tjeter i arsyeshem qe e ben vazhdimin e ortakerise te papranueshme per ortaket e tjere."*

Nje shkak tjeter i tille i arsyeshem sipas paragrafit 1 te ketij neni, duhet te perfshije, por te mos kufizohet ne to, rastet ne te cilat nje ortak:

- a) me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere;
- b) me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj;

pashperndara per zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise te dates 08.07.2007, te pergatitur nga z. Lavdimir Fusha, Ekspert Kontabel i Autorizuar. Zmadhimin e kapitalit themeltar te Shoqerise nga 100.000 leke ne 66 000 000 milion leke. Numri i kuotave te kapitalit, mbetet i pandryshueshem dhe rritet vetem vlera nominante e tyre. Vlera e çdo kuote kapitali kalon nga 1000 leke ne 660.000 leke. Ortaku i vetem i shoqerise do te zoteroje 100% te kuotave te kapitalit themeltar, i cili perbehet nga 100 kuota kapitali). Nderkohe ne date 13.01.2008, me Referencen prane QKB-Numri i ceshtjes: CN-105913-12-07, rezulton se jane shtuar ortakët Pellumb dhe Asim Lluga me kuota 25 % secili, referuar Kontrates Noteriale me Nr.5426Rep dhe Nr. 1514 Kol date 22.10.2007 me titull "Kontrate shitje kuotash te kapitalit te Shoqerise LLUGA sh.p.k".

Referuar Vertetimit te Njesise me Originalin Nr.1103 Rep. date 25.05.2016 eshte paraqitur ne gjykim Pasuria Nr.101/47; Pasuria Nr. 101/49; Pasuria Nr.101/48; Pasuria Nr. 101/50, ne emer te Shoqerise "LLUGA" shpk; Leja e Shfrytezimit date 06.12.2010, te Fabrikes se Prodhimit.

U paraqiten dhe u administruan ne gjykim pasqyrat financiare per vitet 2013, 2014, 2015, dhe Shkresa me Nr.2372/1 Prot. date 23.03.2017, mbi Pasurine me Nr.24/14<sup>+1-3</sup> ZK 8571, ne emer te Hajro Lluges (ku i bashkengjitet Kontrata e Kredise Bankare me kredimarres Shoqerine "LLUGA" shpk), Pasurine me Nr.24/3/2, ZK 8571, ne emer te Hajro Lluges (ne kuader te procedures se legalizimit me Kontraten Nr.148 Rep. Nr.79 Kol. date 24.01.2013 "Mbi kalimin e pronesise se parceles ndertimore").

Gjithashtu, u paraqit ne gjykim kerkesa e pales paditese Asim LLuga ku parashtrohet kundershimi i bilancit vjetor 2014, si dhe shkresa e dates 05.01.2015, mbi shitjen e kuotes, duke bashkengjitur edhe deftesen postare mbi pranimin e ketij objekti postar per komunikim.

Ne keto kushte. pala paditese Asim LLuga, i eshte drejtuar Gjykares se Rrethit Gjyqesor Lushnje duke paraqitur kerkesepadi, me objekt dhe shkak sa me siper.

### **ARSYETIMI I GJYKATËS SË APELIT**

Gjykata e Apelit Vlore, ne lidhje me kete konflikt gjyqesor, çmon se ne Shoqerite me Pergjegjesi te Kufizuar, Ligji per Shoqerite Tregtare, parashikon mundesine e largimit (Neni 101 i ligjit specifik) apo perjashtimit (Neni 102) te nje ortakut nga shoqeria tregtare.

Te dyja keto dispozita, kane disa elemente te perbashket strukturore, siç mund te shihet nga Neni 103 i ligjit, persa i perket pasojave ligjore te largimit dhe perjashtimit, dhe perveç kesaj, ato kane elemente te tjere te perbashket, te cilat dalin ne pah nga nje interpretim i duhur i Neni 101 dhe 102 te LSHT-se.

Pala paditese Asim Lluga parashtron se, gjate kesaj kohe nuk ka marre pjese ne asnje aktivitet te shoqerise, paga, ne masen e pages minimale, i eshte nderprere ne vitin 2017.

Pala e paditur prapesoi se Shoqeria "Lluga" sh.p.k, Hajro Lluga dhe Pullumb Lluga, nuk eshte dakord me vleresimin e paraqitur nga ekspertet, pasi eksperti Kalo Xhuvani ka realizuar vleresimin e makinerive, nderkohe qe nuk ka qene kompetente, si dhe jane vleresuar ndertime pa leje. Ne vijim, pala e paditur ka prapesuar se vlera per te cilen jane dakord per likuidimin e kuotes, eshte shuma 31.454.318 leke, duke parashtruar se pala paditese duhet te paguaje detyrimin tatimor prej 15% qe rrjedh nga vleresimi mbi vleren kontabile, e cila eshte ne masen 11.106.183 leke. Sipas pales se paditur, ortaku Asim Lluga ka qene i punesuar ne kete shoqeri se bashku me familjaret e tij, dhe ne vitin 2012 nuk e kane perjashtuar edhe pse shoqeria ka pesuar deme nga veprimet e tij.

Ne lidhje me kerkesen e pales paditese Asim Lluga per diskutimin e bilancit vjetor date 05.01.2015, kjo kerkese, eshte e pabazuar ne ligj, pasi deklaratat tatimore kryhen perkatesisht brenda dates 31 mars te vitit pasardhes, dhe jo me vone se 31 korrik te vitit kalendarik, duke saktësuar se kjo kerkese nuk mund te perbeje njoftim per largimin nga shoqeria. Sipas pales se paditur Shoqeria "Lluga" sh.p.k, Hajro Lluga dhe Pullumb Lluga, nuk rezulton se ka pasur kerkese me shkrim te pales paditese Asim Lluga per largimin nga shoqeria. Ne lidhje me kerkesat e tjera, pala e paditur prapeson se ato nuk u provuan ne gjykim, pasi nuk u sollen prova shkresore. Ne vijim, pala e paditur prapesoi se Shoqeria "LLUGA" ka lene kolateral disa nga asetet e saj me qellim ndihmen financiar te pales paditese Asim Lluga ne lidhje me perballimin e kredise financiare. Ne perfundim, pala e paditur prapeson se ne lidhje me likuidimin e kuotes, gjykata duhet te kete parasysh nenin 12, pika 7, te statutit te shoqerise, ku paditesi mund te beje transferimin e tyre tek te tretet me te njejten vlere qe do caktoje gjykata, dhe te ushtroj te drejten e parablerjes duke njoftuar me pare ortaket e shoqerise.

Gjate gjykimit, rezultoi e provuar se, Shoqeria "LLUGA" sh.p.k, eshte regjistruar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne daten 13.10.1995, me objekt te veprimtarise, sipas asaj te regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit: "Prodhim, tregtim, artikuj, llamarine e hekuri, prodhime profile dura alumini, import, eksport artikuj industrial", dhe me tre ortake: Asim Lluga, Pellumb Lluga, Hajro Lluga me perqindje te pjesemarrjes sipas pjeseve te zoteruara perkatesisht 25%, 25% dhe 50%. Kjo shoqeri fillimisht eshte krijuar me Vendim Nr.12439, datë 13.10.1995, të Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me ortak dhe administrator te vetem Z.Hajro Lluga. Ne vijimesi te veprimtarise se kesaj shoqerie ortaku dhe administratori i vetem Hajro Lluga i eshte drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane per zmadhimin e kapitalit themeltar:

-Depozitimin e Vendimit Nr.4, date 09.07.2007, i ortakut te vetem te Shoqerise "LLUGA"shpk ku eshte vendosur: Miratimin e Raportit te Ekspertit per vleresimin e kontributeve ne natyre dhe rezervave e fitimeve te

**Se katerti**, ky vleresim nuk qendron edhe per faktin se eksperti Kalo Xhuvani, ka liçence per vleresimin e pasurive te paluajtshme, por ai nuk ka liçence per te vleresuar makineri pajisje te llojit qe disponon shoqeria "Lluga" si furra shkrirje apo sisteme ajrimi dhe ftohjeje, pra ka bere nje vleresim per te cilin nuk eshte liçensuar.

Sa me siper, kerkojme lenien ne fuqi te vendimit gjyqësor civil nr. 433 (1022), datë 31.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, si te bazuar ne prova dhe ligj.

### **GJYKATA E APELIT VLORE**

pasi dëgjoi **relatorin e çështjes, Gjyqtarin Skënder Damini**;  
dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit dhe pranimin e plotë të padisë;  
dëgjoi përfaqësuesin e palës së paditur, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit;  
dhe shqyrtoi çështjen në tërësi

### **V Ë R E N**

Vendimi gjyqësor civil nr. 433 (1022), datë 31.05.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, është një vendim jo i drejtë, dhe i pabazuar në prova dhe ligj dhe si i tille, ai duhet të ndryshohet, lidhur me masen e kuotes se ortakut Asim Lluga, e cila duhet te jete ne vleren 31.454.318 ( tridhjetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e katërmijë e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë, si dhe interesat bankare mbi këtë shumë, nga data e ngritjes së padisë datë 16.07.2015, deri ditën e ekzekutimit të vendimit, llogaritur këto interesa sipas bonove të thesarit në kohën respektive, për këto arsye:

#### **Rrethanat e çështjes**

Pala paditese Asim Lluga parashtron se, eshte ortak me 25 % te kuotave ne Shoqerine "LLUGA" shpk, dhe se ne vitin 2014, ka pasur mosmarreveshje me ortakët e tjere Hajro dhe Pellumb Lluga, pasi kane marre vendime pa u konsultuar me te, nuk e kane njoftuar dhe thirrur ne asamblene e ortakeve, e cila duhet te mblidhej dy here ne vit, si dhe ne rastin e miratimit te bilancit vjetor.

Pala paditese Asim Lluga parashtron se i eshte drejtuar ne daten 05.01.2015, administratorit dhe ortakut tjetër per mbledhjen e asamblese se ortakeve, me qellim diskutimin dhe miratimin e bilancit vjetor, mirepo kjo e drejte, i eshte mohuar. Ne vijim, i eshte drejtuar ortakeve te tjere per parablerjen e kuotes se tij, duke kerkuar caktimin e nje eksperti te pavarur per likuidimin e kuotes, mirepo perseri palet e paditura, i jane pergjigjur negativisht, duke mohuar te drejtat e tij.

viteve 2016 dhe 2017 sipas rezultateve te pasqyrave financiare respektive te ketyre viteve, ai pohon indirekt se Gjykata ka vepruar drejt ku ne dhenien e vendimit te saj eshte bazuar ne gjendjen kontabile te pasqyrave financiare me dt. 31.12.2015.

Nisur nga ky fakt dhe Gjykata e Rrethit Gjyqesor Lushnje, bazuar ne Aktin e ekspertimit te ekspertimit, Eksperti kontabel Bajram Callmori, ne pergjigje te pyetjeve te bere nga Gjykata, ku kerkohet qe pasi te analizohen aktivet dhe pasivet e shoqerise "Lluga" shpk ... te percaktohet sa eshte vlere qe paditesi duhet te perfitoj si kompesim nga qenia aksioner me 25% te kuotave ne kapitalin themeltare te kesaj shoqerie jep kete pergjigje:

1-Llogaritja e vleres 25% te aksioneve te paditesit Asim Lluga e bere sipas pasqyrave financiare me dt. 31.12.2015 (pasi padia eshte regjistruar me dt 16.07.2015, pra kur ka qene miratuar bilanci financiar i vitit 2015 nga ortaket) dhe vlere totale e shoqerise "Lluga" sh.p.k. me dt.31.12.2015, ku perfshihen (toka, ndertesat, impjantet dhe makineri, mjete transporti, aktivete afatshkurtra dhe detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata) eshte ne shumen 84 523 144 leke.

2- Pjesa takuese e paditesit Asim Lluga, i cili zoteron 25% te kapitalit eshte e barabarte me 21.130.786 lekë (84 523 144 lekë 25%), pra sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dt.31.12.2015 (pasqyra financiare te miratuara edhe nga Organet tatimore) vlere e aksioneve te paditesit Asim Lluga, eshte 21.130.786 leke.

Ne lidhje me pretendimin se nuk eshte marre ne konsideratë rivlerësimi i shoqerise sipas aktit te rivlersimit te ekspertit Kalo Xhuvani, kemi sqaruar me siper se Gjykata ka vepruar drejte, shoqeria "Lluga" sh.p.k. nuk ishte dhe nuk eshte ne fazen e likujdimit perfundimtar per te bere rivleresim, por gjithashtu theksojme faktin se edhe po te merrej ne konsiderate, ishte i papranushem per arsye se:

**Se pari,** Vlere kontabile e aktiveve te shoqerise "Lluga" sh.p.k. sipas vleresimit te ekspertit te caktuar nga gjykata vlere e aktiveve te shoqerise eshte 137 669 360 lek ose +116% mbi vleren kontabile, gje, e cila eshte e pamundur pasi aktivet kane amortizim fizik dhe moral qe nuk eshte marre ne konsiderat nga eksperti.

**Se dyti,** Eksperti ka vleresuar siperfaqet ndertimore, pa leje ndertimi (pra te pa regjistruar ne ZVRPP) ne shumen 12.492.360 leke, si mund te behet ky vleresim per pasuri te ndertuar pa leje dhe te parregjistruara ato ne bilanc (aktivet e shoqerise). Nuk mund te vleresohen e te pjestohen pasuri te paluajtshme, te cilat me pare nuk jane te regjistruara ne ZVRPP !!!.

**Se treti,** Eksperti vleresues ka bere rivleresimin e makineri, pajisje ne shumen 42 965 000 leke nga 23 976 171 leke, qe eshte vlere e tyre kontabile, pra duke shtuar vleren e tyre me 18 961 959 lek ose me + 79 %, pa marre ne konsiderat amortizimin fizik dhe moral te ketyre makineri pajisje.

minorances per likuidimin e kuotes se tij.

Keta te fundit, kane kundërshtuar aktin e pare te ekspertimit vetem per pjeset e makinerive dhe kane qene dakort per vlerat e lena ne kete akt ku pjesa takuese e paditesit Asim Lluga per 25% te kapitalit te tij deri ne bilancin e deklaruar me date 31.12.2015 eshte e barabarte me shumen 40 803 522 (dyzet milion e tete qinde e tre mije e pese qind e njezet e dy) leke edhe nga ana jone i qendrojme ketij vleresimi dhe kerkojme ti shtohen, pjesa takuese e fitimit e dy bilanceve atij te 2016 me bilanc (fitimi i shoqerise) pozitiv 15 321 654 (pesembedhjete milione e treqinde e njezet e nje mije e gjashteqind e pesedhjete e kater) leke, ku pjesa takuese e paditesit eshte e barabarte me 3 830 413 (tre milion e tete qinde e tridhjete mije e kater qinde e trembedhjete) leke si dhe fitim sipas bilancit te 2017 me bilanc (fitimi i shoqerise) pozitiv i barabarte me 19 465 222 (nentembedhjete milion e katerqinde e gjashtedhjete e pese mije e dyqind e njezet e dy) leke, ku pjesa takuese e paditesit eshte 4 866 305 (kater milion e teteqind e gjashtedhjete e gjashte mije e treqind e pese) leke.

Perfundimisht vlera e kuotave per ortakun e minorances per te cilen kerkojme eshte e barabarte me 49 500 240 (dyzetë e nëntë milion e pesëqind mijë e dyqind e dyzetë) lekë, pa shtuar ketu deri ne ditën e ekzekutimit.

Sa siper kerkojme nga Gjykata e Apelit Vlore:

Ndryshimin e Vendimit nr.433 (1022), datë 31.05.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje.

Vlerësim të pasurisë dhe likuidim të kuotes së Ortakut të minorancës prej 25% të aksioneve-pasurisë të shoqërisë "Lluga" sh.p.k. duke u përlllogaritur kjo kuotë, deri ne datën që ky vendim të marrë formë të prerë në shumën totale 49 500 240 (dyzetë e nëntë milion e pesëqind mijë e dyqind e dyzetë) lekë, pa shtuar ketu deri ne ditën e ekzekutimit.

**Kundër këtij ankimi, brenda afateve ligjore, bazuar në nenin 456 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë Apel në kundërshtim, pala e paditur, e cila ka parashtruar ndër të tjera këto shkaqe në ankim:**

**Se pari**, shoqëria "Lluga" sh.k.p. eshte aktive dhe nuk eshte ne fazen e likuidimit perfundimtar te saj per te bere rivleresimin e asetëve te saj me qellim likuidimin e ortakeve sipas pjeseve takuese, kjo u provua nga pasqyrat financiare te paraqitura si prove si dhe treguesit financiare te shoqerise.

**Se dyti**, duke qene nje shoqeri aktive, kjo shoqeri ka nje vlere kontabel e cila ne dt 31.12.2015, sipas bilanceve (pasqyrave) financiare te miratuara nga organe te specializuara, si organet tatimore dhe te depozituara prane QKB, eshte ne shumen 84.523.144 leke, si rrjedhim edhe pjesa takuese e paditesit Asim Lluga 25% eshte ne shumen 21.130.786 leke. Theksojme se ne keto pasqyra jane te pasqyruara te gjitha fitimet dhe humbjet e mbartura nga shoqëria Lluga ne vite( deri me dt 31.12.2015).

**Se treti**, pretendimi i paditesit Asim Lluga per te kerkuar edhe detyrimet e

Ortakut që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqëritë me shkrim, si dhe të parashtrijë shkakun e largimit. Administratori duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dënimin për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme.

Ortakut ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit asambleja e përgjithshme nuk mbledhet apo nuk i njeh si të arsyeshme shkakun e largimit dhe likuidimin e kuotës.

E para duhet të ketë një kërkesë nga pala për largimin nga shoqëria. Pra kur thuhet largimi përpos kërkesës së kërkuarit duhet që administratori sipas pikës 3 të nenit të mesipër duhet të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme menjëherë pasi të kenë marrë dënimin për njoftimin e largimit, sipas pikës 2 të këtij neni, për të vendosur nëse ortakut do t'i likuidohet kuota, si pasojë e largimit për shkak të arsyeshme, por siç rezultojë e provuar dhe e provuar nuk kemi asnjëherë mbledhje të asamblesë për këtë motiv dhe as që pala të jetë njoftuar. Përpos kësaj kërkesë e z. Asim Lluga është për shitjen e kuotave të tij dhe nuk shprehet për largim pra kërkesë për shitje sish verëhet dhe në pikën 17 të arsyetimit të vendimit.

Përpos kësaj ligji përcakton se në rast mosgjete dakortësie për largimin e ortakut ose në rast se asambleja nuk mbledhet. Në rastin konkret i jemi drejtuar gjykatës sipas pikës 4 të nenit 101 të ligjit "Për shoqëritë tregëtare" dhe se arsyetimi i vendimit të gjykatës nuk qëndron, kur shprehet se "largimi i ortakut ka efekt të menjëhershëm dhe të drejtat e tij në shoqëri shuhen në momentin kur deklaron vullnetin për largimin" nëni 103 *"Te gjitha të drejtat, që rrjedhin nga cilesia e ortakut në shoqëri, shuhen në datën e largimit ose të vendimit të formës së prare të gjykatës për largimin ose përjashtimin"*.

Pra, në rastin konkret, të gjitha të drejtat do të shuhen, datën, në të cilën ky vendim për largim dhe likuidimin e kuotave do të marrë formë të prare. Do të nderpriteshin ditën e largimit, vetëm nëse kërkesa do të ishte depozituar por dhe pranuar apo shqyrtuar nga pala tjetër pra nga ortakët e mazhorancës. Por, në rastin konkret, siç rezultoi e provuar, administratori por edhe shoqëria, nuk ka ndjekur asnjë procedurë për trajtimin e kërkesave, por *de fakto* e ka përjashtuar që me parë se të bëjë kërkesa për shitje kuotash duke mos e bërë pjesë e asnjë aktiviteti të saj, por duke mos e lënë as të hyjë në ambientet e shoqërisë.

Në këto kushte, kërkimi i jone shtrihet jo vetëm përsa kanë përcaktuar aktet e ekspertimit deri në datën 31.12.2016, por deri në datën që ky vendim do të marrë formë të prare, duke u futur këtu dhe ai për vitin 2017 dhe në vazhdim.

Vendimi i gjykatës, bie ndesh edhe me kërkesat e ortakëve të shumicës që gjatë deklarimeve të tyre në seanca gjyqësore, por edhe siç rezultojë në argumentimin e vendimit të gjykatës kanë qenë të gatshëm të likuidojnë shumën prej 31 454 318 (tridhjetë e një milion e katërqind e pesëdhjetë e katër e treqind e tetëmbëdhjetë) lekë. Dhe po ashtu kanë deklaruar në seancat audio se kishin propozuar me parë 320 mijë euro ortakut të

Ne perfundim, Gjykata e Shkalles se Pare, ka vendosur per pranimin per likuidimin e kuotes likujdoje kuoten e ortakut Asim Lluga ne masen 25% te kapitalit te shoqerise, ne shumen 21.130.786 (njëzetë e një milion e njëqind e tridhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, referuar aktit te ekspertimit kontabel, për shkak të largimit. Duke ju referuar aktit te ekspertimit me perilogaritje pjesa takuese e paditesit Asim Lluga per 25% te kapitalit te tij deri ne bilancin e deklaruar me date 31.12.2015, eshte e barabarte me vleren 21 130 786 (njëzetë e një milion e njëqind e tridhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2015 (ne te cilen nuk jane llogaritur vlera shtese e aktiviteteve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme).

Pra sic verehet nga akti i ekspertimit, nuk jane marre ne konsiderate nga Gjykata, por as vleresuar ne aktin e ekspertimit vlera shtese e aktiviteteve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme, por vetem nga ai kontabel.

***Nje vendim eshte teresisht i njeanshem dhe ne kundersiztim me ligjin.***

Kjo per faktin se ne argumentimin e saj, gjykata ka bere nje interpretim te gabuar te ligjit material duke u shprehur se: "*Largimi nga shoqeria sjell pasoja, sic jane nderprerja e marredhenieve me shoqerine, rimbursimi i kontributit qe ka dhene ortaku qe largohet ne kapitalin e shoqerise, nderprerja e pjesemarrjeve ne mbledhjet e asamblese etj.*"

Ne lidhje me efektet e largimit, megjithese me ligj nuk parashikohen shprehimisht, ato jane te menjehershme. Ky konkluzion arrihet ne formulimi i nenit 103 i ligjit, i cili trajton pasojat e largimit te ortakut nga shoqeria. Ne ligj parashikohet se te drejtat qe rrjedhin nga cilesia e ortakut ne shoqeri shuhen ditën e largimit. Pra, largimi i ortakut ka efekt te menjehershem dhe te drejtat e tij ne shoqeri shuhen ne momentin kur deklararon vullnetin per largimin, ndaj ai nuk mund te pretendoje me per fitime apo marrje pjese ne mbledhjen e asamblese se ortakeve kur ka deklaruar largimin e tij nga shoqeria. Gjithashtu edhe humbjet qe mund te pesoje shoqeria gjate aktivitetit te saj ne kete periudhe nuk mund te prekin ortakun qe ka deklaruar vullnetin per te zgjidhur kontraten e shoqerise. Njoftimi per largim iu drejtohet administratorit ose administratoreve te shoqerise si perfaqesues te kesaj te fundit.

Ne kundersiztim me interpretimin qe i ben gjykata Ligji per Shoqerite Tregtare, percakton ne nenin 101 te tij se: "*Largimi i ortakut per shkaqe te arsyeshme*"

Ortaku mund te largohet nga shoqeria, nese ortakët e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

rrit shpenzimet ne menyre fiktive pasi shoqeria nuk ka kryer keto shpenzime. Madje shpenzime te tjera per mirembajtjen e makinerive nuk jane kontabilizuar edhe pse keto shuma jane harxhuar duke blere pjese pa futura per makinerite.

Duke mare shkas nga parregullsitet e konstatuara dhe veprimet e padrejta e te papergjegjshme te Administratorit, i cili ka pergjegjesine civile e penale per te administruar sipas dispozitave ligjore ne fuqi te gjithe dokumentacionin administrativo ligjor qe ka te beje me aktivitetin ekonomik te shoqerise "Lluga" sh.p.k.

Ortaku Asim Lluga kerkoi qe Gjykata te nominoje nje ekspert kontabel te pavarur me qellim percaktimin e vleres se kuotes qe i perket ortakut posedues te 25% te aksioneve te shoqerise.

Nga ana e Gjykates, jane vendosur fillimisht si eksperte per perlllogaritjen e kuotes se ortakut te minorances ekspertet Kalo Xhuvani ekspert per vleresimin e pasurive te paluajtshme si edhe eksperte kontabel Elida Dhima, te cilet ne vijim te pyetjeve te drejtuara nga Gjykata kane arritur ne konkluzionin se pjesa takuese e paditesit Asim Lluga per 25% te kapitalit te tij deri ne bilancin e deklaruar me date 31.12.2015, eshte e barabarte me shumen 40 803 522 (dyzetë milion e tetëqind e tremijë e pesëqind e njëzetë e dy) lekë.

Me pas, me ndryshimin e perberjes se trupit gjykues, eshte verejtur se njeri prej eksperteve, te cilet kishin perpiluar raportin kontabel, ishte ne konflikt interesi me njerin prej anetareve te treshes gjykuese dhe eshte vendosur per ekspert te ri kontabel dhe konkretisht ekspertin Bajram Callnuri, i cili se bashku me ekspertin Kalo Xhuvani, kane bere nje akt te ri ekspertimi ku kane dale me dy variante, persa i perket perlllogaritjes pjesa takuese e paditesit Asim Lluga per 25% te kapitalit te tij, deri ne bilancin e deklaruar me date 31.12.2015, eshte e barabarte me vleren 21130 786 (njëzetë e një milion e njëqind e tridhjetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë, sipas te dhenave te pasqyrave financiare te dates 31.12.2015 (ne te cilen nuk jane llogaritur vlera shtese e aktiviteve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme).

Pra, siç verhet ne aktin ne fjale, nuk jane analizuar dhe perfshire vlera shtese e aktiviteve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme.

Njekohesisht, ne gjykim, eshte paraqitur dhe relatuar dhe akti i ekspertimit shtese i cili ka perlllogaritur se pjesa takuese e paditesit Asim Lluga per 25% te kapitalit te tij deri ne bilancin e deklaruar me date 31.12.2016 eshte e barabarte me shumen 40 694 958 (dyzetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, ku perfshihet dhe vlera shtese te aktiviteve qe vjen nga vleresimi i kryer nga eksperti vleresues i pasurive te paluajtshme.

Ne baze te nenit 6: Regjistrimet kontabel justifikohen me evidence mbeshtetese, ne forme dokumentare ose informatike, qe sigurojne besueshmerine e tyre. Evidenca mbeshtetese mbahet si prove dokumentare gjate gjithë periudhes koliore, te percaktuar ne nenin 17 te ketij ligji.

2. Per çdo regjistrim kontabel duhet te shkruhet origjina, natyra, data dhe permbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes.

Neni 7 Inventari i aktiveve dhe detyrimeve 1. Njesite ekonomike, subjekte te ketij ligji, duhet te kontrollojne, te pakten nje here ne vit, ekzistencen dhe vleresimin e aktiveve, te detyrimeve dhe te kapitaleve te veta, nepermjet inventarizimit te ketyre elementeve dhe evidences se tyre mbeshtetese.

2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nen pergjegjesine dhe sipas procedurave te miratuara nga organi i drejtimit te njesise ekonomike, qe aktivet dhe detyrimet te paraqiten me vertetesi dhe besueshmeri ne pasqyrat financiare vjetore.

Bilanci i shoqerise "Lluga" sh.p.k. permban te dhena jo te verteta/te paqarta dhe jo korrekte edhe per keto arsye:

Neni 68 i shoqerive tregtare percakton se:

Ortaket e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar i vleresojne kontributet ne natyre ne marreveshje te ndersjella me njeri-tjetrin dhe i shprehin vlerat e tyre ne para. Nese nuk mund te arrihet nje marreveshje, secili prej ortakeve mund t'i drejtohet gjykates perkatese, per te ngarkuar nje ekspert vleresues, me nje vendim me efekt detyrues. Raporti i ortakeve ose i ekspertit per vleresimin e kontributeve i dorezohet Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me te dhenat e tjera te kerkuara per regjistrim.

Ne vleresimin e kapitalit te shoqerise ZERAT: toka, ndertesa, makineri dhe paisje, mjete transporti, nuk jane pasqyruar me vleren reale te tregut por me vlere shume here me te ulet.

Mungese totale e dokumenteve mbeshtetes per disa zera te bilancit per veprime te kryera fiktivisht qe nuk rezultojne te jene kryer. Gje cila bie ndesh me Nenin 3 i ligjit Nr.9228, date 29.4.2004 "*Per kontabilitetin*", i cili percakton se: "*Evidenca mbeshtetese*", eshte dokumenti baze, dokumenti plotesues dhe regjistrat (librat) kontabel, qe pergatiten ne leter te shkruar ose ne bartes informatike: a) Dokumentet baze permbajne regjistrimet fillestare te çdo ngjarjeje dhe veprimi ekonomik; b) dokumentet plotesuese jane bartes te informacionit te marre nga dokumentet baze; c) regjistrat (librat) kontabel jane bartes te informacionit te regjistruar ne menyre kronologjike dhe sistematike te efekteve te veprimeve ekonomike te kryera, te marra nga dokumentet baze ose dokumentet plotesuese.

Ne ZERIN "*parapagime ndaj furnitoreve*", eshte percaktuar shuma prej 12,126,607 kur ne fakt shoqeria "Lluga" sh.p.k. nuk ka kryer asnje blerje me parapagim dhe nuk rezultojne ne te vertete faturat tatimore per keto veprime. Amortizimi i llogaritur per makinerite dhe mjetet ne pronesi te shoqerise, eshte rreth 33% i vleres totale te tyre, gje, e cila bie ndesh me ligjin "*Per kontabilitetin*" dhe pasqyrat financiare, i cili percakton si limit te vleres te amortizueshme, te jete rreth 15%. Rritja fiktive e vleres reale te amortizimeve,

Rezultojne te jene kryer raportime te rreme dhe deklarime te mallrave me vlere me te ulet ne blerje dhe rritje e koston e shitje.

Gjithashtu parregullsi konstatohen edhe persa i perket disa Zerave te bilancit vjetor ku permendet se Shoqeria "Lluga" sh.p.k. ka nje Rezerve prej 13 milion Leke, i cili mund te perdoret per arsye ekonomike qe kane lidhje vetem me aktivitetin e shoqerise. Ky fond reserve. nuk mund te tjetersohet, ndryshohet, pa Vendim te Asamblese se Ortakeve dhe kurrsesi nuk mund te shperbehet, pasi bie ndesh me dispozitat ligjore ne fuqi.

Administratori dhe Ortaket e maxhorances, nuk kane dhene asnje shpjegim se ku ka perfunduar ky fond rezerve, nuk dihet se ne çbanke eshte mbyllur kjo shume, te cilen aktualisht shoqeria "Lluga" sh.p.k. nuk e disponon. Natyrshem lind pyetja ku perfunduan parate e fondit rezerve prej 13 milion Leke.

Administratori duhet te jape shpjegime se ku eshte ky fond, perse nuk jane parate e fondit ne llogarine e shoqerise dhe ku kane perfunduar.

Ortaket e maxhorances, ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe statutin e shoqerise, i mbajne te fshehura keto transaksione, si dhe shume veprime te tjera ekonomike, te ardhurat e te cilave perfundojne ne llogarite personale te ortakeve dhe punonjesve te shoqerise dhe jo ne llogarine e shoqerise. Ne kete menyre jane demtuar rende interesat e Ortakut te minorances Z.Asim Lluga, i cili eshte ankuar me qindra here per keto parregullsi, por ortaket e tjere nuk i kane dhene asnje shpjegim, duke i mohuar edhe te drejten e kontrollit mbi keto transaksione te kryera jashte sistemit bankar, jashte llogarive te shoqerise, duke i perdorur per interesa personale.

Keto metoda te perdorura kane ulur fiktivisht pasurine e shoqerise dhe vleren e asetëve te saj prandaj vleresimi i pasurive te shoqerise duhet te kryhet mbi inventarin fizik te pasurive, makinerive qe posedon shoqeria "Lluga" sh.p.k. Vlera e asetëve, pasurive, makinerive, te mirave etj do te rezultojne shume here me e larte se vlera fiktive e pasqyruar ne bilancet e shoqerise te cilat jane realizuar per te penalizuar e ulur ndjeshem vleren e kuotes se Ortakut Asim Lluga.

Gjate ketij 6 mujori te pare te vitit 2015, shoqeria "Lluga" sh.p.k. ka kryer veprime ekonomike. duke blere lende te pare dhe shitur prodhimet e saj industrial, por çuditerisht fitimet nuk deklarohen dhe nuk gjejne pasqyrim ne faturat mujore. Pjesa me e madhe e ketyre veprimeve, kryhen me para cash, jashte sistemit te kontabilizimit dhe parate qarkullojne ne llogarite e ortakeve te afermeve te tyre ose pagesat e shitjeve merren me para fizike, cash, gje, e cila e ben te pamundur regjistrimin e vlerave te sakta te xhiros se kryer dhe fitimeve te shoqerise. Kontabilizimi i veprimeve te paqarta qe nuk rezultojne nga faturat, eshte kryer dhe keto veprime qe nuk gjejne pasqyrim ne aktivitetin ekonomik te shoqerise, jane bere pjese e bilancit vjetor. Ky fakt bie ndesh me dispozitat ligjore ne fuqi, pasi çdo veprim ekonomik duhet te gjejte mbështetje ne fatura reale, te qarta, me çmime reale dhe ne mungese te gjeje mbështetje ne dokumente mbështetës.

Persa i perket shkaqeve te tjera te arsyeshme, per te cilat lejohet largimi i ortakut, ne ligj nuk gjejme nje percaktim te detajuar lidhur me ate se çfare do te konsiderohen te tilla, ndaj ne statutin e shoqerise mund te percaktohen shkaqe te tjera, perveç atyre qe percakton ligji. Gjithashtu, dhe nga vete ortaket ose asambleja e ortakeve mund te vleresohen shkaqe te tjera si te arsyeshme.

E drejta e largimit te ortakut nga shoqeria, eshte pare si nje e drejte, ne veçanti, e ortakut ne pakice per tu mbrojtur nga vendimet e asamblese se ortakeve, me te cilat nuk eshte dakort, ose te cilat ndryshojne ne thelb kontraten, marreveshjen e themelimit te shoqerise.

Duke u mbeshtetur ne interpretimin e nenit 101 te LSHT, gjykata ka vleresuar se perfundimi i ortakesise ne rastin konkret, vjen per shkaqe te arsyeshme, pasi nga sa rezultoi gjate hetimit gjyqesor, eshte bere e pamundur vijimesia e ortakerise ndermjet paleve ndergjyqese.

Gjykata gjate hetimit gjyqesor, ka konstatuar se edhe pse sipas referimit te nenit 95 te Ligjit nr.9901 "*Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare*", parashikon se administratoret kane te drejte e detyrohen te pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim, kjo gje nuk eshte bere nga administratori. Referuar percaktimeve mbi modalitet e mbledhjes, vijon me tej Gjykata, se asamblese se pergjithshme nuk rezulton e provuar nese pala e paditur ka zhvilluar ndonje mbledhje dhe nese ka marre ndonje vendim ne kuader te mosmarreveshjeve. Edhe pse nga ana e gjykates jane konstatuar nje pjese e pretendimeve te paditesit per arsyt e mosmarreveshjeve ndermjet ortakeve ku ka konstatuar edhe pamundesine per vazhdimin e metejshem te ortakerise, Gjykata nuk ka marre ne konsiderate parregullsitet e bilancit dhe te zerave te permbledhur ne pasqyrat financiare si vijon:

Ne bilancin e shoqerise "Lluga" shpk ne ZERIN huate dhe parapagime ndaj klienteve, rezulton nje shume prej 22 milione leke.

Ne hartimin e bilancit, rezultojne disa mallra dhe produkte me vlere jo reale, te cilat jane vleresuar qellimisht me vlere te ulet ne kete menyre duke ndikuar ne perllogaritjen e fitimit vjetor i cili rezulton te jete 7,579,581 leke. Ky nenvleresim i qellimshem eshte kryer per te ulur fitimet e shoqerise dhe si konseguence uljen e tatim fitimit, fshehjen e fitimit real duke rritur shpenzimet dhe ulur marxhin e fitimit.

Shkelje e dispozitave ligjore per deklarimin e veprimeve ekonomike dhe perpilimin e pasqyrave financiare mbi bazen e deklarimeve te rreme/false.

Administratori i shoqerise dhe eksperti kontabel kane llogaritur nje norme amortizimi rreth 30% te shumes total e te vleres se kapitalit dhe vleres se makinerive gje e cila bie ne kundershtrim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

I gjendur ne keto kushte te pamundesise per te ushtruar te drejtat e tij si Ortak i shoqerise me 25% te aksioneve, Asim Lluga duke respektuar dispozitat statutore dhe ligjore, iu drejtua me shkrese Ortakeve qe te ushtronin te drejten e parablerjes se aksioneve te Ortakut Asim Lluga, nga Ortaket Hajro Lluga dhe Pellumb Lluga. Asim Lluga kerkoi nga Administratori qe te nominohej nje ekspert i pavarur per te kryer nje akt vleresimi te vleres se aksioneve te shoqerise "Lluga" sh.p.k. dhe mbi kete baze, te kryhej likuidimi i kuotes se tij prej 25%. Administratori dhe Ortaku Pellumb Lluga, i jane pergjigjur negativisht likuidimit te kuotes, duke kundërshtuar kerkesen e tij, persa i perket likuidimit dhe nominimit te nje eksperti kontabel te pavarur per te vleresuar asetet e shoqerise.

Ortaket e maxhorances, ia mohuan kete te drejte, duke e perjashtuar faktikisht nga drejtimi, pjesemarrja ne vendimarrje, perjashtimi nga cdo kontroll mbi aktivitetin ekonomik te shoqerise, pasqyrat financiare, veprimet ekonomike etj. Asim Lluga nuk ka me asnje akses jo vetem ne llogarite, veprimet e shoqerise, por edhe *de facto* nuk lejohej te futej ne ambjentet e punes ku operon shoqeria "Lluga" sh.p.k. Asim Lluga eshte perjashtuar faktikisht, ligjerisht dhe nuk eshte njohur me asnje nga aktet, vleresimet, vendimet e Asamblese se ortakeve edhe pse ka kryer disa kerkesa drejtuar Administratorit te Shoqerise per mbledhjen e radhes ku te kishte mundesi per tu njohur me aktivite, veprimet ekonomike te shoqerise.

Qe prej muajit janar 2015, Asim Lluga dhe familjaret e tij, te punesuar prane shoqerise "Lluga" Sh.p.k. jane detyruar te largohen nga shoqeria, si shkak i mosmarreshjeve dhe perjashtimit te tyre nga Ortaket e shoqerise Hajro dhe Pellumb Lluga.

Duke mos patur mundesi objektive per te ushtruar te drejtat e tij ne cilesine e Ortakut, si shkak e sjelljeve e veprimeve te Ortakeve te maxhorances, Asim Lluga i drejtohet Gjykates se Rrethit Lushnje qe te percaktoje-likuidoje vleren e aksioneve ne posedim te tij, sipas vleres se tregut ne momentin e kerkeses per likuidim.

Ne Lidhje me shoqerite me pergjegjesi te kufizuar, Ligji "Per Shoqerite Tregtare", parashikon mundesine e largimit ose te perjashtimit te nje ortaku nga shoqeria tregtare.

Po ky ligj, ne nenin 103 te tij, percakton qarte se e drejta e ortakeve per tu larguar nga shoqeria, si dhe e drejta e shoqerise per perjashtuar nje ortak, nuk mund te kufizohen nga statuti.

Ligji parashikon se ortaku ka te drejte te largohet nga shoqeria dhe kuota e tij te likujdohet nese ortaket e tjere ose shoqeria:

- a) Kane kryer veprime ne dem te tij;
- b) Nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij;
- c) Nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme;
- d) Apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.

Nje ortak nuk mund te detyrohet te qendroje ne shoqeri, atehere kur ai pengohet te ushtroje te drejtat e tij, kur i jane ngarkuar detyrime te paarsyeshme, apo per shkaqe te tjera te arsyeshme.

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje**, me vendim gjyqësor civil nr.433 (1022), datë 31.05.2018, ka vendosur:

*“Pranimin pjeserisht te kerkese-padise se pales paditese Asim Lluga ne lidhje me ceshtjen civile me Nr. Regj. Them. 18/29/124/766 (936), date regjistrimi 16.07.2015.*

*Detyrimin e pales se paditur Shoqerise "LLUGA" sh.p.k, te likuidoje kuoten e ortakut Asim Lluga ne masen 25% te kapitalit te shoqerise, ne shumen 21.130.786 (njezet e nje milion e njeqind e tridhete mije e shtateqinde tetedhete e gjashte) Leke, referuar aktit te ekspertimit kontabel per shkak te largimit.*

*Urdherohet regjistrimi i ketij vendimi prane Qendres Kombetare te Biznesit. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales se paditur ne masen e pranuar te kerkesepadise...”*

**Kundër këtij vendimi, breda afateve ligjore, bazuar në nenin 452 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë ankim në Apel, pala paditëse, e cila ka parashtruar ndër të tjera këto shkaqe në ankim:**

Asim Lluga eshte Ortak i shoqerise “Lluga” sh.p.k. se bashku me shtetasit Hajro Lluga dhe Pellumb Lluga, ne te cilen zoteron 25% te kuotave dhe pasurise te shoqerise.

Gjate ketyre viteve, kemi patur rezultate te shkelqyera ne planin ekonomik, por gjendja u perkeqesua, sidomos gjate 2-3 viteve te fundit.

Me perditesimin e Statutit dhe pershtatjen e tij me ligjin 9901, “Per shoqerite tregtare”, Administratori Hajro Lluga dhe Pellumb Lluga (qe zoterojne 75% te kuotave te aksioneve te shoqerise), filluan te merrnin vendime pa u konsultuar me ortakun e minorances, madje ne te shumten e rasteve, duke shkelur te drejtat e Ortakut.

Shkeljet konsistojne ne mosthirrjen e Asamblese se Ortakeve, sipas dispozitave ligjore dhe statutore ne baze te ciles Administratori duhet te njoftoje dhe mbledhe Asamblene e Ortakeve te pakten 2 here ne vit dhe ne rastet e miratimit te bilancit vjetor, kur e kerkojne perfaqesues qe mbajne 5% te aksioneve.

Asim Lluga ne saje te mosmarreveshjeve me Ortaket e tjere dhe me Administratorin ka kerkuar ne date 05.01.2015, me shkrese derguar Administratorit dhe Ortakut Pellumb Lluga qe te mblidhet Asambleja e Ortakeve me qellim diskutimin e miratimit te bilancit vjetor.

Edhe pse e ka rinovuar edhe verbalisht kerkesen per te qene prezent ne miratimin dhe diskutimin e zerave te bilancit vjetor, Asim Lluga iu mohua e drejta e tij si Ortak per tu njohur me Aktet e Shoqerise dhe me nje eveniment madhor sic eshte miratimi i pasqyrave financiare, ku dhe percaktohen politikat ekonomike te shoqerise, ndarja e fitimeve, njohja me humbjet, veprimet e shoqerise etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT  
VLORË

Nr.2368/1342 i Regj.Them.  
Datë 09.07.2018

Nr. 391 Vendimi  
Datë 29.05.2019

V E N D I M

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Apelit Vlorë, e përbërë prej:

**KRYESUES:** Skënder DAMINI  
**ANËTAR:** Sokol NGRESI  
**ANËTAR:** Hysen SALIKO



Asistuar prej sekretares gjyqësore Anila FERRAJ, në Vlorë sot më datë 29.05.2019, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore në Shkallë të Dytë, çështjen civile që u përket palëve:

**PALË PADITËSE:** Asim Lluga, i biri i Hajredinit dhe i Salihes, i dtl.08.01.1961, lindur dhe banuese ne Lushnje, Lagja "Gafur Muço", Rruga "Manastiri i Ardenices", perfaqesuar me deklarim nga av.Saimir Korreshi.

**PALË E PADITUR:**

1. Shoqeria "Lluga" sh.p.k, me adrese: Rruga Lushnje-Fier, Km 3, Rruga e Manastirit, Lagja "Gafur Muço", Lushnje, me administrator Pellumb Lluga.
2. Hajro Lluga, i biri i Hajredinit dhe i Salihes, i dtl.26.08.1951, lindur dhe banuese ne Lushnje, Lagja "Gafur Muço", Rruga "Manastiri i Ardenices".
3. Pullumb Lluga, i biri i Hajredinit dhe i Salihes, i dtl.18.05.1958, lindur dhe banuese ne Lushnje, Lagja "Gafur Muço", Rruga "Manastiri i Ardenices".

Të përfaqesuar ne gjykim me deklarim nga Av.Artan Kodheli.

**OBJEKTI:** Vleresim te pasurise dhe likuidim te kuotes se ortakut te minorances prej 25% te aksioneve-pasurise te Shoqerise "Lluga" sh.p.k.


**BAZA LIGJORE:** Neni 101/4, 231 e vijues i Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqeritë tregëtare", i ndryshuar, Kodi Civil, Nenet 31, 32, 154/a, 334, 335 i Kodit te Procedurës Civile.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT VLORË

Nr .2368 Akti

Vlorë, më 11.07.2019



DEFTESE - KOMUNIKIMI

\* Bashkëngjitur me kete Shkrese , Ju dergojme kopjen e :  
Vendimit civil Nr.391 , date 29.05.2019 te dhene nga Gjykata e Apelit Vlore ( S.Damini).

PALA E PADITUR  
Pellumb Lluga

Adresa : Rruga e Manastirit Ardenices , L. "Gafur Muco"  
Lushnje

Shperndaresi

Mora dijeni sot, me date \_\_\_\_\_

SHËNIM:

- Në rast paraqitje rekursi, ai **duhet domosdoshmërisht të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën, në aq kopje sa janë palët.**
- Rekursit duhet t'i bashkëngjitet **prokura e posaçme për avokatin**, kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar .
- Bashkë me rekursin **duhet të paguhet edhe tarifa gjyqësore në masën 200 lekë.**

Sekretare gjyqësore

Anila Ferraj

Neni 474 i Kodit te Procedures Civile parashikon se:

"Rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë **duhet të nënshkruhet nga avokati që e përfaqëson palën** dhe nëse pala e kërkon, edhe nga kjo e fundit.

Neni 476 i Kodit te Procedures Civile parashikon se:

"Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, **në afatën prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.** Së bashku me rekursin duhet të depozitohet:

a) kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe kur është rasti edhe e njoftimit kur ky është bërë;

b) **prokura e posaçme;**

c) aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar rekursi, në aq kopje sa janë palët.

Sekretaria e gjykatës, që ka dhënë vendimin e kundërshtuar, përcjell zyrtarisht në sekretarinë e Gjykatës së Lartë dosjen përkatëse së bashku me dokumentet e mësipërme.

**Kur nuk plotësohen këto kushte, palës i caktohet një afat 10 ditor për të bërë plotësimet dhe, nëse pas këtij afati nuk bëhen plotësimet, rekursi kthehet."**

Shtojca Nr.1 e Udhezimit te Përbashkët nr.33/2014 te Ministrisë dhe të Ministrisë të Financave parashikon se:

"A.Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokure

9. Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës është 200 lekë ."



RR 607 102 442 AA